

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Organizatat e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/25/organizatat-e-medias-denoncojne-sjelljen-e-policise-n-daj-gazetares-se-citizens-al/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:42:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:12:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c1e542de73261912b20fbd149e74ba244f7b6424aa4da71d1bf1fede36e26128
TEKSTI	f34e3c19f0be6a3085365fababc7742fce9f7eb6f19a1be58659bd0ccf92fd7f
PAMJA	c33574dcc97979a6fc46b888ae55b8f96e105504a9d9f6b87c090a21cb27c225

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eac23c60a25e0a587d0722304ac88e9cf6ab7c586992b96ae3e18dc3713d60ae
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eac23c60a25e0a587d0722304ac88e9cf6ab7c586992b96ae3e18dc3713d60ae>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Organizatat e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al

Shoqërimi në Polici i gazetares Citizens.al, Vjolanda Peca gjatë raportimit të protestës dhe mbajtja e telefonit të saj konsiderohen nga organizatat për mbrojtjen e gazetarëve si 'shqetësim serioz' dhe "përshkallëzim i rrezikshëm i sjelljes së Policisë ndaj gazetarëve".



nga Blerina Gjoka

13 seconds më parë

në Lajme

Koha e leximit: 2 min lexim

AA

0



Protestuesit përballen me policinë gjatë protestës së mbajtur më 17 shtator 2026. Foto: LSA.

Rrjeti SafeJournalists reagoi të premten për rastin e shoqërimit nga policia të gazetares së Citizens.al, Vjolanda Peca gjatë raportimit nga protesta e së enjtes, duke shprehur 'shqetësim serioz' për faktin se telefoni i saj celular vijon të mbahet nga policia edhe pas lirim.

Sipas organizatës që mbron të drejtat dhe lirinë e gazetarëve, Peca po mbulonte protestën në cilësinë e saj si gazetare kur u shoqërua nga efektivët e policisë dhe u mbajt në komisarjat dhe se ajo ka deklaruar se policia nuk i ka dhënë asnjë shpjegim për arsyet e sekuestrimit të telefonit të saj.

"Sekuestrimi apo mbajtja e pajisjeve të punës së një gazetari kërkon garanci të posaçme. Telefonat e përdorur nga gazetarët mund të përmbajnë materiale të papublikuara, komunikime me burime dhe informacione të tjera të mbrojtura nga konfidencialiteti gazetaresk. Çdo ndërhyrje në këto materiale duhet të ketë një bazë të qartë ligjore, të jetë e nevojshme dhe proporcionale dhe të shoqërohet me garanci efektive për mbrojtjen e burimeve dhe informacionit konfidencial të gazetarëve," thekson Rrjeti SafeJournalists në deklaratën publike.

Organizata i bën thirrje Policisë së Shtetit dhe autoriteteve kompetente që të sqarojnë menjëherë bazën ligjore për shoqërimin në komisarjat të gazetarës si dhe për sekuestrimin dhe vijimin e mbajtjes së telefonit të saj dhe t'i kthejnë pa vonesë pajisjen, përveçse nëse vijimi i mbajtjes së saj mbështetet në një masë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale, të shoqëruar me garancitë e duhura procedurale.

Rrjeti thekson se "çdo sulm ndaj gazetarëve është sulm ndaj demokracisë, interesit publik dhe të drejtave themelore të njeriut".

Media Citizens.al e konsideroi aktin si "pengim i drejtpërdrejtë i punës gazetareske" duke vlerësuar se gazetarët duhet të raportojnë nga terreni pa pengesa dhe pa ndërhyrje.

Edhe Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH) reagoi të premten duke i bërë thirrje policisë që t'i kthejë telefonin gazetares.

Organizatat e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al

15:12 | 25/09/2026

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

13:37 | 25/09/2026

Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

11:34 | 25/09/2026

Futja e Ballkanit në Shengen: një zgjidhje me përfitime për Evropën

09:59 | 25/09/2026

Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

08:08 | 25/09/2026

Ish-shefja e SHISH, Vlora Hyseni mbetet në 'arrest shtëpie'

15:39 | 24/09/2026

telefonit është një punë për gazetarin dhe mund të përmbajë panje të papublikuara, komunikime me burime konfidenciale dhe të dhëna personale. Mbatja e tij mund të pengojë raportimin dhe të rrezikojë mbrojtjen e burimeve"- thotë AGSH në qendrimin publik.

Po ashtu AGSH e konsideroi shoqërimin e saj në policie si një akt të ndërmarrë në kushte tërësisht të papërshtatshme duke qenë se nga dokumentimi i pamjeve filmike Peca ka qenë qartësisht e identifikueshme si gazetare.

Organizata po ashtu e konsideron këtë ngjarje si "një përshkallëzim i rrezikshëm i sjelljes së Policisë ndaj gazetarëve dhe mediave në tërësi".

Etiketa: Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë Citizens.al Policia e Shtetit Protesta Safe Journalist Network Vjollanca Peca

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontaktimi
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Slida.PRO](#)